



Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministri of Education, Science and Technology

Praktika Pozitive në arsimin gjithëpërfshirës



Prishtinë, 2017

**Departamenti për Politikat e Arsimit Parauniversitar
Divizioni i Arsimit me Nevoja të Veçanta
Qendrat burimore për mësim dhe këshillim**

*Gjithëpërfshirja e fëmijëve me nevoja
të veçanta arsimore në Kosovë*

*(Hulumtim i realizuar nga
mësuesit udhëtues)*

PËRMBAJTJA

1. Hyrje në arsimin gjithëpërfshirës	8
1.1 Qëllimi i dokumentimit të praktikave pozitive	10
1.2 Dobitë nga arsimi gjithëpërfshirës	12
1.3 Komponentët për shkollë dhe klasë gjithëpërfshirëse	13
1.4 Qendrat burimore dhe roli i tyre për arsim gjithëpërfshirës	15
1.5 Mësuesit udhëtues dhe mbështetja profesionale për arsim gjithëpërfshirës	16
2. Metodologjia	18
3. Dokumentimi i praktikave pozitive në shkolla gjithëpërfshirëse	20
3.1. Qendra burimore për mësim dhe këshillim “Përparimi” Prishtin	21
3.2. Qendra burimore për mësim dhe këshillim “Lef Nosi” Prizren	32
3.3. Qendra burimore për mësim dhe këshillim “Nëna Terezë” Mitrovicë	40
3.4. Qendra burimore për mësim dhe këshillim “Nëna Terezë” Prizren	52
3.5. Qendra burimore për mësim dhe këshillim “Xheladin Deda” Pejë	58
4. Përfundim	62
Shtojcë	65



“Shkollat e rregullta me orientim gjithëpërfshirës janë mënyra më efektive për luftimin e diskriminimit, krijimin e komuniteteve mikpritëse, ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe arritjen e arsimit për të gjithë”

Deklarata e Salamankes dhe Korniza për Veprim 1994, Neni 2

SHKURTESAT

- QB** - Qendra burimore
PIA - Plani Individual i Arsimit
NVA - Nevoja të veçanta arsimore
MAShT - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
SHFMU - Shkolla fillore dhe e mesme e ulët
UNESCO - United Educational, Science and Cultural Organization¹

¹ Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë.



FIGURAT

Fig. 1 - Arsimi gjithëpërfshirës

Fig. 2 - Vizatim i nxënësit

Fig. 3 - Paraqitja e procesit të hartimit të PIA-s

Fig. 4 - Përfshirja e fëmijëve në klasë

Fig. 5 - Procesi i gjithëpërfshirjes

Fig. 6 - Aktivitete gjatë orës së edukatës fizike

Fig. 7 - Gjithëpërfshirja sociale

Fig. 8 - Gjithëpërfshirja në mësim

Fig. 9 - Aktivitete në klasë

Fig. 10 - Paraqitja e punës së nxënësës së përfshirë në klasë

Fig. 11 - Numri i nxënësve të mbështetur sipas viteve

Fig. 12 - Shkolla "Lekë Dukagjini" Prizren

Fig. 13 - Pamje nga klasa

Fig. 14 - Bashkëmohatarët në mbështetje të fëmijëve me NVA

Fig. 15 - Loja në grup

Fig. 16 - Gjithëpërfshirja

Fig. 17 - Bashkëmohatarët në përkrahje

Fig. 18 - Shkolla për të gjithë

Fig. 19 - Paraqitja grafike e nxënësve të integruar

Fig. 20 - Aktivitete në shkollë

Fig. 21 - Shkolla gjithëpërfshirëse

Fig. 22 - Shkolla e hapur

Fig. 23 - Aktivitete në grupe

Fig. 24 - Funksionimi i procesit mbështetës

Fig. 25 - Aktivitete jashtëmësimore

Fig. 26 - Raporti i vizitave të mësuesit udhëtues institucioneve arsimore të Kosovës gjatë vitit shkollor mësimor 2014/2015

Fig. 27 - Numri i nxënësve të identifikuar, të përkrahur e të mbështetur nga mësuesi udhëtues gjatë vitit shkollor mësimor 2014/2015

Fig. 28 - Vizatim i nxënësit

Fig. 29 - Leximi në Brail



Të nderuar mësime, këtu,

Gjithëpërfshirja në arsim shihet si proces reformues i sistemit arsimor në tërësi dhe synim i krijimit të një shoqërie me të drejta të barabarta.

Ky dokument përmban praktikën pozitive të disa shkollave, ku janë përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

Për të paraqitur këto praktika, mësuesit udhëtues kanë hulumtuar dhe kanë sjellë disa shembuj të mirë në gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

Të gjithë ne kemi idenë tonë se çfarë është gjithëpërfshirja, por në fund ajo nënkupton ndryshimin. Gjithëpërfshirja është proces dhe nuk mund të përfundojë si e tillë, ndaj shkollat duhet të përpiqen që atë ta realizojnë në mënyrën sa më të mirë të mundshme.

Në shkollën gjithëpërfshirëse e mendojmë si:

- Shkollë që i pranon të gjithë fëmijët;
- Shkollë që vazhdimisht zhvillohet dhe shkon më tutje;
- Shkollë që kërkon të ndryshojë kulturën, politikën dhe praktikën e saj për t'iu përshtatur të gjithë nxënësve;
- Shkollë që i zvogëlon barrierat për nxënës.

Shpresojmë se me sjelljen e praktikave pozitive tek Ju, mund të ndikojmë në pranimin e idesë se mësuesit në klasa mund të jenë të suksesshëm me të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh sfidat me të cilat ballafaqohen.

Dhe se, në anën tjetër, mësuesit në klasa mund të kërkojnë mbështetje profesionale, që do t'u ofrohet nga mësuesit mbështetës, mësuesit udhëtues dhe profesionistët e tjerë për gjithëpërfshirje sa më cilësore.

Ju urojmë sukses në punën tuaj!



Në tabelë janë paraqitur shkollat me të cilat qendrat burimore kanë realizuar bashkëpunimin

Shkolla	Vendi	
Shkolla fillore dhe e mesme e ulët	"Motrat Qiriasi"	Prizren
Shkolla fillore dhe e mesme e ulët	"Lekë Dukagjini"	Prizren
Shkolla fillore dhe e mesme e ulët	"Hilmi Rakovica"	Prishtinë
Shkolla fillore dhe e mesme e ulët	"Nazim Gafurri"	Prishtinë
Shkolla fillore dhe e mesme e ulët	"Musa Hoti"	Mitrovicë
Gjimnazi	"Zenel Hajdini"	Gjilan
Shkolla fillore dhe e mesme e ulët	"Zef Lush Marku"	Velezhë/Prizren
Shkolla fillore dhe e mesme e ulët	"Ismail Qemali"	Prishtinë
Shkolla fillore dhe e mesme e ulët	"Bedri Gjina"	Mitrovicë



1. Hyrje në arsimin gjithëpërfshirës

Gjithëpërfshirja në arsim mund të shihet si një aspekt i përfshirjes në shoqëri. Është proces i përcaktimit dhe përmbushjes së nevojave të ndryshme të të gjithë fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes në mësim, kulturë dhe komunitete dhe eliminimit të përjashtimit nga arsimi, forcimit të kapacitetit të sistemit arsimor, për të arritur tek të gjithë nxënësit, pavarësisht nga gjendja ekonomike, gjinia, përkatësia etnike, gjuha, aftësia e kufizuar.

Arsimi gjithëpërfshirës është thelbësor për arritjen e cilësisë së lartë në këtë fushë për të gjithë nxënësit dhe për zhvillimin e shoqërive drejt gjithëpërfshirjes.



Fig. 1 - Arsimi gjithëpërfshirës

Sipas Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 40 i këtij ligji, përcaktohet qartë Parimi i arsimit gjithëpërfshirës, që të zbatohet në Republikën e Kosovës, si praktika më e mirë, në përputhje me normat dhe konventat ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Mbështetja përkatëse duhet të ofrohet bazuar në nevojat intelektuale

Komunat marrin masa për të mbështetur përfshirjen e fëmijëve në shkolla të rregullta, sipas vlerësimeve individuale profesionale, dhe sigurojnë transport falas, të sigurt dhe të përshatshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara.



Kështu, shumë shkolla të rregullta në Kosovë, tani kanë përfshirë nxënës me nevoja të veçanta arsimore, që mbështeten nga qendrat burimore në aspektin profesional.

Roli i qendrave burimore në sistemin e mbështetjes është që, nëpërmjet bashkëpunimit, t'u ofrojnë ndihmë shkollave të rregullta, të cilat duhet të përfshijnë nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

1.1. Qëllimi i dokumentimit të praktikave pozitive

Fillimisht janë paraqitur kriteret e shkollës gjithëpërfshirëse, pastaj janë përpiluar pyetësorët për të hulumtuar shkollën, klasën, mësuesin dhe nxënësin model.

Hulumtimi ka filluar me mbledhjen e të dhënave nga secila qendër burimore në rajonin që e mbështet. Në fokus ka qenë identifikimi i shkollave për realizimin e hulumtimit.

Kriteret për përzgjedhjen e shkollave ishin:

1. Shkollat që kanë pranuar fëmijë me nevoja të veçanta arsimore;
2. Shkolla që ka identifikuar mësuesin model në gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta;
3. Nxënës me nevoja të veçanta me rezultate të mira në mësim;
4. Integrim të suksesshëm dhe të socializuar mirë me nxënësit e tjerë;
5. Infrastruktura e përshtatshme shkollore;
6. Mësimdhënës të trajnuar në arsimin gjithëpërfshirës.

Pas identifikimit dhe përzgjedhjes së shkollave gjithëpërfshirëse, janë informuar drejtorët e shkollave, mësimdhënësit dhe prindërit e nxënësve për hulumtimin dhe është marrë miratimi me shkrim.

Ky dokument do të duhej t'i ndihmonte mësimdhënësit në ngritjen e cilësisë në punë me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, dhe të shërbente si model për bashkëpunim me shkollat dhe mësimdhënësit.

Çka është arsimit gjithëpërfshirës?

Arsimi gjithëpërfshirës nënkupton faktin që të gjitha shkollat duhet t'i pranojnë të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh gjendjen e tyre fizike, intelektuale, sociale, emocionale, gjuhësore ose ndonjë gjendje tjetër.¹

¹ Strategjia e Arsimit Parauniversitar 2007-2017.



Vizioni i arsimit gjithëpërfshirës

“Për një sistem arsimor cilësor për të gjithë fëmijët, duke marrë parasysh dhe duke respektuar nevojat, interesat dhe mundësitë individuale.”

Krijimi i një komuniteti gjithëpërfshirës arsimor, është detyrë e secilit anëtar të shoqërisë. Së këndejmi, mbetet përgjegjësi e secilit prej nesh që të japë kontributin e tij maksimal në realizimin e aktiviteteve të parapara, duke qenë të bindur se është shoqëria ajo që përfiton më tepër nga kjo.

Themelin e procesit gjithëpërfshirës e përbëjnë një sërë parimesh, të cilat sigurojnë që fëmijët me nevoja të veçanta arsimore të shihen si anëtarë të vlefshëm të komunitetit shkollor në çdo aspekt të tij. Prandaj, shkollat gjithëpërfshirëse kanë parasysh faktin se të gjithë fëmijët kanë të drejtë të qëndrojnë bashkë në një klasë, afër vendbanimit të tyre.

Që procesi gjithëpërfshirës të jetë efektiv dhe rezultatet të jenë të dukshme, duhet punuar në ndryshimin e shkollës, në mënyrë që të krijohet një shkollë me një koncept të ri, e cila do të jetë e hapur dhe do të promovojë gjithëpërfshirje, barazi dhe qasje për të gjithë fëmijët.



1.2. Dobitë nga arsimi gjithëpërfshirës

Çdo ditë ju mund të keni rastin të takoni nxënës me dallime të ndryshme në nxenie dhe në sjellje. Arsimi i fëmijëve me dhe pa aftësi të kufizuara në shkollën gjithëpërfshirëse mund të jetë me shumë dobi. Këto dobi mund të ndikojnë tek familjet dhe tek mësuesit e tyre.

Dobitë për nxënësit	Dobitë për mësuesit	Dobitë për familjen
<ul style="list-style-type: none"> ○ Zhvillimi i të vlerësuarit dhe respektit për veçoritë karakteristike dhe aftësitë e çdo individit. ○ Rritja e aftësisë për të ndihmuar dhe për të mbështetur të gjithë shokët me ndjeshmëri dhe dallime të tjera. ○ Sigurimi i mundësive për të përjetuar dallimet e shoqërisë në një mjedis arsimor. ○ Mundësia e zhvillimit të marrëdhënieve shoqërore dhe forcimit të vetëbesimit me përfshirje në aktivitete me bashkëmohatarrë. ○ Promovimi i mundësive për komunikim, vetëmbrojtje dhe arsimim me bashkëmohatarrët. 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Shkëmbimi i informatave dhe udhëzimeve profesionale për aktivitetet dhe strategjitë të mësimdhënies, kjo i zgjeron shkathtësisë e të dyja anëve: mësuesve në arsim të përgjithshëm dhe mësueseve mbështetës, udhëtues. ○ Zhvillimi i punës në ekip dhe bashkëpunim, zhvillimi i shkathtësive në zgjidhjen e problemeve me kreativitet dhe përballimin e sfidave në raport me mësimdhënien. ○ Promovimi, njohja dhe respektimi i të gjithë fëmijëve si fuqi dhe anëtarë të rëndësishëm në komunitetin e shkollës. 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Ndjenja pozitive për veten dhe për fëmijët e tyre, duke parë se fëmijët me sukses janë të pranuar nga të tjerët, në ambient gjithëpërfshirës, dhe kanë përkatësi në komunitetin në të cilin jetojnë. ○ Zgjerimi i mundësive përtej komunitetit shkollor, duke nxitur miqësinë e shkollës në aktivitete dhe ngjarje shoqërore.



1.3. Komponentët për shkollë dhe klasë gjithëpërfshirëse

Mësuesit duhet të kenë njohuri për komponentët e shkollave dhe klasave gjithëpërfshirëse. Këta përbërës ofrojnë blloqe të nevojshme ndërtimi të një komuniteti të sigurt dhe mikpritës shkollor, përderisa dallimet individuale vlerësohen dhe përqafohen. Këta komponentë janë: udhëheqja, klima dhe struktura e shkollës, vendosja e nxënësve, përfshirja e familjes dhe komunitetit, praktikat bashkëpunuese, praktikat mësimore dhe shërbimet profesionale.

Udhëheqja

- Drejtorët duhet të promovojnë një ndjenjë përgjegjësie dhe të përbashkët për rritjen akademike, sociale-emocionale të çdo nxënësi në shkollë.
- Drejtorët duhet të sigurojnë që praktikat përfshirëse, të bazuara në dëshmi, të zbatohen në mënyrë efektive.
- Drejtorët duhet të sigurojnë kohën e planifikimit bashkëpunues, si pjesë të strukturës së shkollës.

Klima e shkollës dhe struktura

- Mësuesit duhet të sigurohen që të gjithë nxënësit janë të mirëseardhur dhe t'i shohin si kontribuues dhe anëtarë të vlefshëm në komunitetin e shkollës.
- Marrëdhëniet bashkëpunuese midis stafit, familjeve dhe nxënësve ndërtohen në vazhdimësi.

Ekipi komunal i vlerësimit

Në komuna janë ekipet vlerësuese komunale, te cilat vlerësojnë fëmijët për nevojat e tyre arsimore dhe me këtë shkollat duhet të krijojnë mundësinë e gjithëpërfshirjes së fëmijëve në klasa të rregullta, sipas vendimit që merr ekipi vlerësues.



Fig. 2 - Vizatim i nxënësit





1.4. Qendrat burimore dhe roli i tyre për arsimin gjithëpërfshirës

Funksionimi i qendrave burimore përcaktohet me Ligjin për Arsimin Parauniversitar (Neni 42) dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 23/2013 për Qendrat Burimore.

Qendrat burimore ofrojnë mbështetje, në kuadër të resurseve që kanë në dispozicion, në bazë të kërkesave të institucioneve arsimore dhe aftësuese, që arsimojnë nxënësit me vështirësi në mësim.

Në Kosovë aktualisht funksionojnë pesë qendra burimore, të cilat ofrojnë shërbim dhe këshillim sipas llojit të dëmtimeve për të gjitha shkollat e rregullta, sipas zonave të mbulimit dhe në tërë territorin e Kosovës:

Qendrat burimore që e mbulojnë tërë territorin e Kosovës:



Qendrat burimore për dëmtime intelektuale dhe zonat e mbulimit:

Qendra burimore "Përparimi" Prishtinë

- Prishtinë, Fushë-Kosovë, Lipjan, Gjilan, Novobërdë, Ferizaj, Viti, Kaçanik, Podujevë, Obiliq, Shtime, Kamenicë dhe Graçanicë

Qendra burimore "Nëna Terezë" Mitrovicë

- Mitrovicë, Istog, Skenderaj, Vushtrri, Pejë, Klinë, Drenas, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq

Qendra burimore "Lef Nosi" Prizren

- Prizren, Mamushë, Gjakovë, Deçan, Rahovec, Malishevë, Suharekë, Shtërpcë, Dragash dhe Junik.



1.5. Mësuesit udhëtues, mbështetës profesionalë për arsimin gjithëpërfshirës

Mësuesit udhëtues janë profesionistë me përvojë në lëmin e edukimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, në mbështetje të procesit gjithëpërfshirës në arsim.

Vlerësimi i nevojave për mbështetje pedagogjike:

- a) Promovimi i arsimit gjithëpërfshirës për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore;
- b) Identifikimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në sistemin arsimor dhe jashtë tij;
- c) Vlerësimi i nevojave për mbështetje pedagogjike;
- ç) Realizimi i procesit të transicionit për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- d) Këshilla profesionale për mësimdhënës për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore;
- dh) Pjesëmarrja në ekipin për hartimin dhe rishikimin e planit individual të arsimit;
- e) Modifikimi i kurrikulës dhe materialeve në baza individuale;
- ë) Monitorimi i procesit të gjithëpërfshirjes, bashkëpunimi me drejtori komunale, shkolla dhe organizata joqeveritare;
- f) Krijimi i bazës së të dhënave për numrin e nxënësve të mbështetur profesionalisht në procesin e gjithëpërfshirjes;
- g) Puna individuale me fëmijë.

1.6. Planit Individual i Arsimit

Ç'është Planit Individual i Arsimit?

Planit Individual i Arsimit (PIA) është dokument zyrtar pedagogjik, i cili hartohet për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, për të cilët ekipi vlerësues komunal apo edhe ekipi në nivel institucioni ka marrë vendim për arsim me nevoja të veçanta arsimore.

Planit Individual i Arsimit shërben për planifikimin sistematik të nxënies, mësimdhënies, për mbështetjen dhe ndjekjen e përparimit individual të fëmijës.

Planit Individual i Arsimit duhet të zhvillohet përmes një procesi bashkëpunues, duke përfshirë shkollën, prindërit, fëmijët (kur është e përshtatshme) dhe personelin tjetër përkatës. PIA është një dokument i besueshëm (konfidencial) dhe informatat për të mund t'u jepen të tjerëve vetëm me lejen e prindërve. Ai i referohet përshtatjes së kurrikulës dhe fokusohet në nevojat me prioritet të nxënësit.

PIA përcakton:

- Qëllimet edukative, arsimore të fëmijës për periudhën që zgjat planit individual;
- Rezultatet e të nxënit të fëmijës, përmes të cilave realizohet qëllimi i vendosur;
- Metodat dhe format e punës të nevojshme për të realizuar rezultatet e të nxënit;
- Burimet e nevojshme për shërbimet që duhen ofruar si dhe burimet ekzistuese;
- Përmbajtjen e lëndëve mësimore të individualizuara ose fushave të aktiviteteve;
- Format e vlerësimit të fëmijës;
- Personat përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e PIA-s;
- Procesin e monitorimit dhe rishikimit të tij.

Hapat më të rëndësishëm në hartimin e Planit Individual të Arsimit




Fig. 3 - Paraqitja e procesit të hartimit të PIA-s



2. Metodologjia



Praktika pozitive në arsimin gjithëpërfshirës

Hulumtimet janë aksionale dhe janë realizuar për të paraqitur praktikat arsimore në arsimin gjithëpërfshirës në disa shkolla të Kosovës.

Metodat e aplikuara gjatë hulumtimit:

Instrumentet që janë përdorur janë: *anketa dhe intervista.*

Teknikat e përdorura janë: *e vëzhgimit, e intervistës, e anketës dhe e testimit.*



3. Dokumentimi i praktikave pozitive në arsimin gjithëpërfshirës



3.1. Qendra burimore për mësim dhe këshillim

“Përparimi” Prishtinë

Qendrat burimore për mësim dhe këshillim, me shërbimet mbështetëse profesionale për shkollat e rregullta, kanë filluar punën në shtatorin e vitit 2007.

Puna e mësuesve udhëtues (dy) në vitet e para ishte promovimi i rolit të tyre, vetëdijesimi për ndryshimet në politika arsimore, në aspektin e gjithëpërfshirjes, mbështetja profesionale e nxënësve me nevoja të veçanta dhe mësimdhënësve në sistemin arsimor.

Në fillimet e punës ishin sfidat për ndërtimin e kulturës për gjithëpërfshirje në shkollat ku kishte dhe ku ne integronim fëmijë me nevoja të veçanta.

Pastaj duhej të ndërtohej praktika e gjithëpërfshirjes, që ishte punë konkrete me mësues dhe nxënës.

Dhe, me Ligjin për Arsimin Parauniversitar (2011) ne kishim mbështetje për arsimin gjithëpërfshirës, të cilin duhej ta implementonim sa më mirë në kushtet dhe rrethanat e vendit tonë.

Tani përfshirja e nxënësve është në rritje dhe vetëdijesimi i mësimdhënësve dhe kompetencat profesionale janë në nivel më të lartë.

Numri i nxënësve të përfshirë çdo ditë është duke u shtuar dhe me këtë edhe praktika pozitive që mund të shërbejë si model në arsimin gjithëpërfshirës.

Mësueset udhëtuese në qendrën burimore “Përparimi” në Prishtinë. (Me cilën pjesë?)



Praktika pozitive në arsimin gjithëpërfshirës

Për të dokumentuar praktikat pozitive në punën me fëmijë me nevoja të veçanta, fillimisht kemi përcaktuar disa kritere se çka është shkolla gjithëpërfshirëse:

- Niveli i bashkëpunimit me shkollën-mësuesin, psikologun;
- Bashkëpunimi i shkollës me prindërit;
- Numri i mësimeve të përfshirë në trajnime të organizuara nga QB "Përparimi";
- Implementimi i trajnimeve në punë praktike;
- Zbatimi i Planit Individual të Arsimit;
- Niveli i arritshmërisë së nxënësit.


Për matjen e këtyre kritereve, kemi hartuar pyetësorë për mësimeve, psikologë dhe prindër. Kurse me drejtorët kemi realizuar intervista. Pyetësori është bërë me të gjithë mësimeve dhe mbështetur dhe është realizuar drejtpërdrejt në klasë, me qëllim të monitorimit të punës së mësueses me nxënës me nevoja të veçanta dhe zbatueshmërinë e PIA-s në praktikë. Si materiale të tjera kemi përdorur edhe PIA-t (objektivat e arritura) dhe dosjet e nxënësve.

Për përdorimin e këtyre të dhënave dhe fotografive si dokumentim, janë marrë lejet nga drejtorët, mësimeve dhe prindërit.

Praktikat e mira në përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në shkollën "Hilmi Rakovica"

Shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Hilmi Rakovica" në Prishtinë është përzgjedhur si shembull i praktikave pozitive në gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

Bashkëpunimin me këtë shkollë, Qendra Burimore ka filluar në vitin 2015, ndërsa gatishmëria e stafit për të bashkëpunuar ka rezultuar pozitive, duke e lehtësuar procesin (nëpërmjet përballimit të sfidave) për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë.





Vizioni i shkollës "Hilmi Rakovica" Prishtinë

"Zhvillimi maksimal i të gjithë nxënësve në shkollë duke i aftësuar për të nxënë gjatë gjithë jetës, në përputhje me vlerat e arsimit gjithëpërfshirëse dhe kërkesat e shoqërisë së përparuar demokratike".

Qëllim thelbësor i kësaj shkolle është përfshirja e qëndrueshme e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në klasë. Për të arritur këtë qëllim, i tërë stafi i shkollës punën e tyre e kanë përqendruar në krijimin e një ambienti të përshtatshëm, bashkëpunues dhe llogaridhënës.

Procesi i përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në shkollën "Hilmi Rakovica"

- Identifikohen nxënësit gjatë kohës së regjistrimit në shkollë nga psikologjia e shkollës, apo edhe nga mësueset, të cilat i referojnë pastaj tek psikologjia
- Kontaktohet prindi për diskutim, referohet për vlerësimin
- Kontaktohet qendra burimore - mësuesit udhëtues
- Hartohet PIA
- Monitorohet puna në zbatim të PIA-s nga psikologjia-mësuesit udhëtues
- Hartohen materiale sipas objektivave dhe nevojave të nxënësit
- Dokumentohet puna me nxënës - dosjet e nxënësit
- Mbahen takime të rregullta me prindër
- Raportimi

Pas vlerësimit të nxënësve, sistematizimi i tyre në klasë bëhet sipas udhëzimit administrativ 22/2013.

Shërbimet e ofruara nga qendra burimore

Qendra burimore “Përparimi” mbështet profesionalisht me këshilla shkollën “Hilmi Rakovica” për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në procesin gjithëpërfshirës arsimor. Ka organizuar trajnime, në të cilat nga kjo shkollë numri i mësimeve ka qenë i madh.

Temat e trajnimit	Numri i mësuesve	
Plani Individual i Arsimit	22	
Metodologjia e mësimit	22	
Prodhimi i materialit didaktik	22	

Përveç trajnimeve dhe këshillave të vazhdueshme profesionale, qendra burimore “Përparimi” Prishtinë ka ofruar edhe këto shërbime:

- Janë organizuar dy takime grupore me mësimeve të ciklit të mesëm të ulët për implementimin e PIA-s;
- Mbështetje profesionale në hartimin e PIA-s;
- Rishikime të PIA-s;
- Materiale të modifikuara;
- Konsulta dhe mbështetje e vazhdueshme.



Fig. 4 - Përfshirja e fëmijëve në klasë



Fig. 5 - Procesi i gjithëpërfshirjes



Shërbimet mbështetëse të mësuesve udhëtues të qendrës "Përparimi" përfshijnë shumë komuna dhe shkolla dhe praktika të mira ka gjithandej. Me këtë rast kemi paraqitur praktikën e mira nga shkolla "Nazim Gafurri" dhe besojmë që në vazhdimësinë e dokumentimit të praktikave pozitive do të përfshihen edhe komuna e shkolla të tjera të mira në vend.

Fig. 6 - Aktivitete gjatë orës së edukatës fizike



Mësuesja e suksesshme

Ndër përvojat pozitive në shkollën “Nazim Gafurri” kemi veçuar përvojën e mësueses Pashije Bunjaku dhe nxënësen O.M.

P.B. procesin mësimor e ka filluar pasi O.M. ka mbaruar klasën e parë. Fillimisht mësuesja është angazhuar të punojë në krijimin e një ambienti të përshtatshëm në klasë.

O.M. kishte qenë e ulur në mes të klasës, gjë që e bënte të vështirë gjithëpërfshirjen e saj. Nuk dëshironte të ishte e pranishme në klasë dhe, si pretekst, shumicën e kohës kërkonte të shkonte në tualet. Po ashtu, edhe nxënësit e tjerë nuk kishin një qëndrim të duhur ndaj saj. Kur mësuesja e filloi punën me këtë klasë, nuk kishte njohuri të mjaftueshme për qasje ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta dhe për punën sipas PIA-s.

Sfida me e madhe e mësimit nxënëses ka qenë sensibilizimi dhe bashkëpunimi me nxënësit dhe prindërit e tyre lidhur me mbështetjen, përkrahjen dhe praninë e O.M. në klasë.

Për kapërcimin e këtyre sfidave dhe krijimin e një atmosfere me të mirë në klasë, mësuesja ka kaluar nëpër këta hapa:

- Takimi dhe bashkëpunimi me psikologun e shkollës;
- Takimi me prindërit për informim dhe sensibilizim;
- Takimi me nxënësit në klasë, krijimi i rregullave të përbashkëta me nxënësit;
- Krijimi i rregullit të uljes në klasë (çdo muaj secili nxënësi ka ndërruar shokun e bankës, duke përfshirë edhe O.M.);
- Vendosja e punimeve të nxënësve në tabelë – duke përfshirë edhe O.M.;
- Përzgjedhja e punimeve;
- Organizimi i lojërave-aktiviteteve kreative për të përfshirë të gjithë nxënësit;
- Përdorimi i strategjive mësimore.

Mësuesja tani ka arritur të krijojë klimë të mirë në klasë dhe të menaxhojë mirë tërësitë situatën. Ka arritur që t’i vetëdijesojë nxënësit në klasë për të respektuar dallimet individuale, për t’i pranuar, për t’i toleruar, për të ndihmuar dhe për të bashkëpunuar. Ata, po ashtu, tani mund t’i shohin edhe mangësitë e veta dhe të zhvillojnë aftësi për t’i korrigjuar ato. Kanë fituar aftësi për udhëheqje dhe për ndjenjën e përgjegjësisë.

Për ngritjen profesionale në raport me punën sipas objektivave individuale, mësuesja ka ndjekur trajnimet e organizuar në QB “Përparimi”, të cilat ka arritur t’i zbatojë shumë mirë në punën praktike në klasë. Tani mësuesja ka arritur të zbatojë planin individual të arsimit dhe punën me O.M. ta realizojë sipas objektivave individuale, por njëherësh edhe të realizojë punë në grupe me nxënësit, duke mos e ndarë nga nxënësit e tjerë të klasës.

Teknikat dhe materialet mësimore janë të planifikuara në PIA dhe ato zbatohen edhe në

praktikë. Modifikimin dhe hartimin e materialeve të nevojshme mësuesja arrin ta bëjë vetë, duke i shfrytëzuar edhe njohuritë e marra në trajnime rreth prodhimit të materialeve mësimore.

- Mësuesja ndjek punën me PIA dhe arrin të shënojë të gjitha arritjet e nxënësës dhe t'i dokumentojë ato;
- Mësuesja ka një listë të takimeve me prindin, që i realizon për ndjekjen e punës me PIA - takime të vazhdueshme individuale me prindër;
- Mban dosjen e nxënësit;
- Harton teste individuale, sipas objektivave individuale;
- Përdor metoda multishqisore të mësimdhënies.

Gjatë procesit mësimor, mësuesja aplikon metoda dhe strategji të ndryshme të punës. Bashkëpunimi me mësuesit udhëtues është i vazhdueshëm dhe të gjitha këshillat profesionale arrin t'i implementojë në klasë.



Fig. 7 - Gjithëpërfshirja sociale

Sukseset e nxënësës

O.M. filloi klasën e parë në shkollën "Nazim Gafurri" në vitin shkollor 2013-2014. Në klasën e parë ajo e kishte një mësuese tjetër. Në fillim të vitit shkollor ajo shkonte me dëshirë në shkollë, por më pas, me shtimin e obligimeve dhe detyrave, të cilat ajo nuk mund të arrinte t'i "kryente", O.M. çdo ditë filloi të gjente arsye të reja për të



Fig. 8 - Gjithëpërfshirja në mësim

mos shkuar në shkollë dhe të qante. Sido që të jetë, ajo vazhdoi klasën e parë, po edhe në orë të mësimt gjente arsye për të dalë nga klasa, me pretekst për nevojat fiziologjike. Në klasën e parë iu hartua Plani Individual, së bashku me mësuesen udhëtuese dhe psikologun e shkollës. Ajo ende nuk i kishte përvetësuar aftësitë dhe shkathtësitë akademike në raport me moshatarët e vet. Pas hartimit të PIA-s, mësuesja me O.M. nisi të punonte sipas objektivave të parapara në PIA. Mirëpo, në fund të klasës së parë, mësuesja ndryshoi pozitën e punës.

Klasën e dytë O.M. e filloi me një mësuese të re, ajo ishte mësuesja Pashije Bunjaku.

Për O.M., ardhja e mësueses së re ishte diçka që e shqetësonte, sepse ajo vazhdonte me avazin e vjetër, me arsyet e saj për mosardhje në shkollë (arsye për t'u larguar nga klasa) dhe të tjera.

Mësuesja që nga fillimi kërkoi ndihmë nga psikologu i shkollës dhe nga prindi, e më vonë edhe nga mësuesit udhëtues, në mënyrë që të bënte një strategji të qasjes sa më të drejtë dhe të arsyeshme ndaj O.M.

Për shkak të vështirësive në artikullimin e tingujve, O.M. ngurronte të shprehej verbalisht dhe kjo shkaktoi nervozë tek ajo, me drojën e përqeshjes nga të tjerët.

Tani, edhe pse vazhdon t'i ketë këto vështirësi, ajo nuk ngurron të marrë fjalën dhe të shprehet lirshëm.

Ky rezultat është arritur falë vetëdijesimit të nxënësve në klasë dhe qasjes së drejtë nga ana e mësueses. Po ashtu, ajo ka arritur të marrë pjesë në aktivitete grupore, merr iniciativë për bashkëbisedim, është e socializuar dhe është e mirëpritur nga të gjithë. Sa u përket aftësive dhe shkathtësive të jetës së përditshme, O.M. arrin të orientohet mirë brenda hapësirave, ka filluar edhe të mësojë dhe orientimit në kohë, kujdeset për gjërat personale etj.

Objektivat individuale mësimore O.M. vazhdimisht arrin t'i realizojë në afatin e caktuar kohor. Përderisa në fillim ajo ishte duke mësoar njohuri themelore, në njohjen e shkronjave

dhe numrave, tani ajo ka arritur të lexojë dhe të bëjë llogaritje matematikore (mbledhje dhe zbritje të numrave).

Një ndër rezultatet e arritura në lëndën e matematikës është se O.M. për një kohë të gjatë ka ngatërruar numrin 4 me 7, mirëpo, me ndihmën e mësueses, ajo tani arrin të bëjë këtë dallim në atë mënyrë që numri 4 evidentohet me një ngjyrë (të kuqe), ndërsa numri 7 me ngjyrë tjetër (të kaltër). Gjithashtu vlen të përmendet se në fillim O.M. kishte një përqendrim të shkurtër, ndërsa tash ka arritur që të ketë përqendrim më të gjatë në aktivitetet shkollore.

Për më shumë, po paraqesim pjesë të PIA-s, ku prezantohet puna e mësueses dhe rezultatet e nxënës.



Fig. 9 - Aktivitete në klasë

Objektivat mësimore për nxënësen O.M.

Gjuhë shqipe	Matematikë
<ul style="list-style-type: none"> ○ O.M. të jetë në gjendje të shkruajë duke bashkuar pikat; ○ O.M. të jetë në gjendje të shkruajë duke shikuar modelin; ○ O.M. të jetë në gjendje t'i njohë shkronjat: A, I, N, M, E; ○ O.M. të jetë në gjendje të ngjyrosë brenda kufijve; ○ O.M. të jetë në gjendje t'i lidhë fjalët me shkronjat që i njeh; ○ O.M. të jetë në gjendje t'i njohë shkronjat e mëdha te shtypit: L, E, R, U, C, O, P, B, H, T, S, SH, F, J, D, Q, K. <p>25.09.2014</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ O.M. do të jetë në gjendje të mësojë shkronjat e mëdha të shtypit: DH, LL, G, GJ, TH, Ç, NJ, Y, X, XH, ZH, RR; ○ O.M. do të jetë në gjendje që me shkronjat e mësuara të mësojë nga 3-4 fjalë të reja; ○ O.M. do të jetë në gjendje që të emërtojë dhe të lidhë figurat me shkronjat përkatëse (p.sh., foton e rrushit me shkronjën RR); <p>03.6.2015</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Të lexojë rrokjet; ○ Të lexojë fjalë në rrokje (2 rrokje); ○ Të lidhë fjalën me fotografi; ○ Të bëjë diktim në rrokje; ○ Të përshkruajë fjalë. <p>8.12.2015</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Njeh dhe dallon emrin dhe gjininë e emrit; ○ Lexon fjali të shkurtra; ○ Lidh figurën me karakteristikat e saj. <p>31.5.2016</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Lexon dhe komenton një pjesë të tekstit; ○ Dallon mbiemrin; ○ Dallon fjalitë dëftore, pyetëse dhe dëshirore. <p>04.05.2017</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Përmes diktimit shkruan fjalën në rrokje. 	<ul style="list-style-type: none"> ○ O.M. do të jetë në gjendje të bëjë grupimin e gjërave; ○ O.M. do të jetë në gjendje t'i njohë ngjyrat: e kuqe, e kaltër, e verdhë, e zezë, e gjelbër; ○ O.M. do të jetë në gjendje të numërojë deri në 10; ○ O.M. do të jetë në gjendje të njohë konceptin e numrave deri në 10; ○ O.M. do të jetë në gjendje të njohë rrethin, katrorin, trekëndëshin. <p>25.06.2015</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ O.M. do të jetë në gjendje të bëjë mbledhjen dhe zbritjen e numrave me mjetet konkrete deri në numrin 10+(të përvetësohet zbritja e numrave); ○ O.M. do të jetë në gjendje të bëjë renditjen e numrave nga më i madhi deri tek më i vogli dhe anasjelltas deri në 20; ○ Njohja e numrave deri në 20. <p>31.5.2016</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Mbledh numrat logjikisht deri në 10; ○ Dallon numrat çift dhe tek; ○ Dallon dhe shkruan numrat deri në 50; ○ Dallon njëshet dhe dhjetëshet; ○ Mbledh numrat dyshifrorë. <p>04.05.2017</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Dallon dhe shkruan numrat deri në 100.



D.M.



Lepuri i bardhë.

Lepuri

i bardhë.

Lepuri i bardhë.



Nëna e dashur.

Nëna

e dashur.

Nëna e dashur.



Gota e gjatë.

Gota

e gjatë.

Gota e gjatë.

Emri: Olga

Mësuesja : Pashije Bunjaku

Prishtinë, 28.09.2016

Fig. 10 - Paraqitja e punës së nxënësës së përfshirë në klasë




3.2. Qendra burimore për mësim dhe këshillim “Lef Nosi” në Prizren

Qendra burimore “Lef Nosi” në Prizren ofron mbështetje profesionale për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në mësim. Qendra ka dy mësues udhëtues, të cilët i identifikojnë dhe i mbështetin profesionalisht mësuesit dhe nxënësit në dhjetë komuna. Kjo qendër burimore, që nga viti shkollor 2015/16 e deri më tani, ka identifikuar dhe ka mbështetur mbi 60 nxënës në këto komuna.

Disa prej shkollave gjithëpërfshirëse, që qendra burimore i mbështet profesionalisht, kanë treguar rezultate të mira në fushën e gjithëpërfshirjes, janë pranuar mirë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, kanë bashkëpunim të mirë me qendrën burimore, aplikojnë forma dhe metoda profesionale gjatë procesit të mësimdhënies me nxënës.

Fig. 11 - Numri i nxënësve të mbështetur sipas viteve



Për dokumentimin e përvojave pozitive në fushën e arsimit gjithëpërfshirës në mesin e shkollave, mësuesit udhëtues, duke pasur për kriter identifikimin e shkollave dhe mësimdhënësve, që kanë treguar “praktika pozitive”, si dhe nxënësve me nevoja të veçanta, që kanë treguar rezultate të mira, kanë bërë një hulumtim në shkollën “Lekë Dukagjini” në Prizren dhe në shkollën “Motrat Qiriazi” në Prizren.

Shkolla gjithëpërfshirëse "Lekë Dukagjini" në Prizren

Është shkollë gjithëpërfshirëse, sipas një definicioni më të gjerë, pasi ajo i ka përfshirë të gjitha komunitetet e fëmijëve, si: shqiptarë, boshnjakë, turq, romë dhe ashkali. Gjithashtu, në këtë shkollë janë të përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.



Fig. 12 - Shkolla "Lekë Dukagjini" Prizren

Shkolla ka krijuar një kulturë për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta, ka bashkëpunim të mirë me prindërit, me qendrën burimore dhe organizatat e tjera që merren me fëmijë me nevoja të veçanta.

Është shkollë me infrastrukturë të mirë, klasa të ndriçuara, pjerrina, mjete mësimore dhe mësimdhënës të trajnuar. Disa nga mësimdhënësit nga kjo shkollë kanë ndjekur trajnime për gjithëpërfshirjen dhe punën edukativo-arsimore me nxënës me nevoja të veçanta, por theksojnë nevojën edhe për trajnime të mësimdhënësve të tjerë, pasi kjo shkollë ka një numër të madh të mësimdhënësve.

Klasa gjithëpërfshirëse

Për të dokumentuar këto përvoja, ne kemi zgjedhur mësuesen model në këtë shkollë. Mësuesja ka përvojë pune me nxënës me nevoja të veçanta. Ajo në klasën e saj ka pasur më herët, por edhe tani ka, të përfshirë nxënës dhe ka treguar rezultat të mirë të punës.



Fig. 13 - Pamje nga klasa

Mësuesja ka qasje të mirë me F.K., e ka ulur atë në bankën e parë, ka krijuar kontakt të mirë me të, i përdor nxënësit vullnetarë për t'i ndihmuar F.K.. Përdor metoda dhe strategji të ndryshme të mësimdhënies, si: metodën e demonstrimit dhe ilustrimeve, metodën e shpjegimit, ushtrimeve, jep udhëzime të qarta, demonstrime vizuale, punon me Planin Individual të Arsimit dhe mundohet ta zbatojë atë maksimalisht. Ajo përdor dhe harton materiale mësimore për nevojat e F.K. dhe kërkon ide për hartim të materialeve specifike.

Bashkëpunimi prind-mësues-shkollë është në nivel të lartë dhe ata kanë takime të shpeshta. Prindi është i kënaqur me shkollën dhe mësuesen, pasi ata e kanë pranuar mirë F.K. dhe nuk kanë refuzuar pranimin e fëmijës në shkollë.

Prindi është i kënaqur edhe me rezultatin e F.K. dhe ai thekson se rezultati që e ka është arritur me përkrahjen e mësueses.

Ajo ka arritur të integrohet me sukses, është socializuar mirë me shokët dhe shoqet e klasës dhe tani emocionalisht ndihet mirë, pasi ata bashkëpunojnë dhe i ndihmojnë asaj.

Nxënësit e tjerë e kanë pritur shumë mirë F.K. në klasë, e konsiderojnë si shokët dhe shoqet e tjera të klasës, i ndihmojnë në bartjen e çantës deri në klasë, në lëvizjen e karrocës, në uljen dhe ngritjen nga karrigia në karrocë dhe anasjelltas, i ndihmojnë në detyra, nuk e ngacmojnë, përkundrazi, secili e ndihmon.



Fig. 14 - Bashkëmoshatarët në mbështetje të fëmijëve me NVA

Për sa u përket rezultateve në mësim, ajo brenda këtyre 3 viteve ka arritur të mësojë gati të gjitha shkronjat e shtypit dhe të lexojë me fjalë dyrrrokëshe dhe trerrokëshe, të shkruajë në mënyrë të pavarur, të bëjë mbledhjen dhe zbritjen e numrave njëshifrorë, të njohë të hollat dhe në mënyrë të pavarur të kryejë blerje.



Fig. 15 - Loja në grup

F.K. ka arritur të lëvizë më mirë me anë të karrocës. Ajo është integruar dhe është socializuar shumë mirë me nxënësit e tjerë në klasë dhe emocionalisht ndihet shumë mirë, merr pjesë në të gjitha aktivitetet e klasës.

Nxënësi: A. L.

Është kërkuar kontakti me ne në fillim të vitit shkollor të 2013/14 në një shkollë fillore të qytetit të Prizrenit. Pas takimit me familjen dhe drejtorin e shkollës, i filluam procedurat e integritit.

Duke bashkëbiseduar me shkollën, u vendos të fillohet integrimi. U zgjodh një mësimdhënës me përvojë edhe në edukim me fëmijë me nevoja të veçanta dhe nisi mësimin në shkollë të rregullt dhe në klasë të rregullt te mësuesja Shefike Gamsesi.

Në kontaktet e para me ta, nxënësi ka qenë në një gjendje aspak stabile, ka pasur reagime të shpeshta dhe të ndryshme, hiperaktivitet, vështirësi të natyrave të ndryshme, të cilat nuk përshtateshin me integrim të plotë, ndaj kemi kërkuar integrim me orar të pjesshëm.

Pas këshillave për modifikim të punës dhe organizim të klasës, u fillua me hartimin e PIA-s, me prindër, mësues, drejtor dhe mësues udhëtues, për të vazhduar me dërgimin e materialit në PECS dhe duke u avancuar në vitet në vazhdim.

Për rreth tre vjet angazhim të stafit shkollor, nxënësi në fjalë, përveç fushave të tjera që ka arritje, ka përfituar shumë edhe në aspektin social.



Fig. 16 – Gjithëpërfshirja



Shkolla gjithëpërfshirëse "Motrat Qiriazi" në Prizren

Shkolla ka një numër të madh të nxënësve, ku janë të përfshirë edhe fëmijë nga komunitetet. Në shkollë ka dy klasa të bashkëngjitura në dy gjuhë, në gjuhën turke dhe shqipe.

Drejtori i shkollës ka qasje të mirë, po ashtu edhe mësimmhënësit. Disa nga ta kanë trajnime nga fusha e edukimit special/gjithëpërfshirës në punë me fëmijë.

Shkolla ka zhvilluar kulturën e pranimit të nxënësve me nevoja të veçanta, pa marrë parasysh shkallën e dëmtimeve. Bashkëpunimi është në një nivel mjaft të mirë, si me qendrat burimore, ashtu edhe me prindër dhe udhëheqës shkolle.

Klasa gjithëpërfshirëse

Mësuesja Shefike Gamsesi, para se të punojë me nxënës të rregullt, ka punuar në klasë të bashkëngjitur në të njëjtën shkollë. Ajo paraprakisht ka pasur njohuri për punë me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, ka pranuar integrimin në klasën e saj pa vështirësi dhe me një qasje të duhur.

Disa detyra që ajo i ka realizuar gjatë kësaj periudhe rreth 3-vjeçare janë:

- Bashkëpunimi me prindin;
- Me mësuesin udhëtues;
- Përgatitja e nxënësve të tjerë;
- Puna individuale me fëmijën;
- Puna në grup.

Suksesi është arritur në pavarësimin në lëvizje, në komunikim dhe në shkathtësi të nevojshme jetësore.

Sjellja në klasë është përmirësuar dukshëm, **edhe mjetet mësimore i përdor i pavarur** dhe ka filluar të mësojë nga përmbajtjet mësimore dhe materialet e përshtatshme.

Mësuesja Shefike është zgjedhur si **mësuese model** e gjithëpërfshirjes, në saje të një pune të palodhshme, të përhershme, bashkëpunuese dhe me rezultate të dalluara për këto vite bashkëpunimi.

Nxënësi A. L. ndihmohet shumë nga bashkëmoshatarët në procesin mësimor dhe në aktivitete jashtëmësimore.



Fig. 17 - Bashkëmoshatarët në përkrahje

Angazhim së bashku në: aktivitete shkollore, vallëzim, përgatitje të ushqimit dhe të tjera aktivitete dhe nxënës që ndihmojnë për gjithëpërfshirje.



Fig. 18 - Shkolla për të gjithë



“Pranimi i fëmijës në shkollë ka shkuar në rregull.

Tani ka komunikim të rrjedhshëm në baza ditore me shkollën dhe mësuesen.

Është liruar nga varësia personale (nëna ka qëndruar në klasë, brenda shkollës). Në kohën që po flasim, nxënësi është i pavarur jo veç brenda shkollës, por që nga oborri i shkollës.

Nga moskomunikimi, tani ka qasje të pranueshme dhe komunikim në zhvillim.

Në fillim kishte vështirësi në përqendrim, tani duket stabil pas një periudhë jo të shkurtër.

Nga mbyllja në vete – tani ka interesim të shtuar për gjëra të ndryshme, me interes të vetë nxënësit, p.sh. tani angazhohet për detyra.

Nëna thekson se tani ka një vlerësim edhe më pozitiv për mësuesen, për hapësirën, angazhimin me nxënësit, angazhimin në festa të ndryshme.

Për rreth tre vjet angazhim të stafit shkollor, nxënësi në fjalë, përveç fushave të tjera që ka arritje, ka përfituar shumë edhe në aspektin social.

Nga qëndrimi i prindit në klasë, korridor, shkollë (varshmëria nga nëna), tani nxënësi është i pavarur, nga rreshti deri në përfundim të mësimin.

Nga i mbylluri në vete – tani komunikon me shokët e shoqet e klasës vazhdimisht.

Nga mosmarrja e informatës, në këtë kohë zbaton shumë nga to dhe është kërkues i saj.

Nga frika e nxënësve të tjerë për nxënësin me nevoja të veçanta, në shoqërues të tij si në mësim dhe në aktivitete të ndryshme”

Prindi i fëmijës me nevoja të veçanta i përfshirë në shkollën “Motrat Qirazi” në Prizren



3.3. Qendra burimore për mësim dhe këshillim “Nëna Terezë” në Mitrovicë

Qendra burimore për mësim dhe këshillim “**Nëna Terezë**” në Mitrovicë ofron edukimin dhe arsimimin për fëmijët me dëmtime intelektuale dhe me zhvillim të vonshëm.

Që nga viti 2008/2009 qendra burimore përmes (dy) mësueseve udhëtuese ofron shërbime mbështetëse në shkolla të rregullta.

Gjendja aktuale e aktiviteteve të ofruara nga shërbimet mbështetëse të qendrës burimore është:




Fig. 19 - Paraqitja grafike e nxënësve të integruar

Shërbimet mbështetëse, me përvojë disavjeçare, kanë arritur të bashkëpunojnë me shumë shkolla për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.



Fig. 20 - Aktivitete në shkollë

Për të dokumentuar praktika të mira në mësim të shumë shkollave gjithëpërfshirëse, kemi përzgjedhur dy shkolla, të cilat përmbushin kriteret e një shkolle gjithëpërfshirëse dhe mund t'u shërbejnë si model shkollave të tjera, në aspektin e arsimit gjithëpërfshirës.

Shkolla gjithëpërfshirëse "Musa Hoti "Mitrovicë

Vizioni i shkollës:

Shkolla është e hapur për të gjithë nxënësit, pa dallime, duke mos qenë të ndarë nga nxënësit e tjerë, por, përkundrazi, duke u integruar sa më shumë me moshatarët e vet dhe në shoqëri, përgjithësisht.




Fig. 21 - Shkolla gjithëpërfshirëse

Një numër i konsiderueshëm i mësimitdhënësve të shkollës janë trajnuar nga qendra burimore "Nëna Terezë" dhe organizata të tjera në këto tema:

1. Plani Individual i Arsimit;
2. Format e reja mësimore - prodhimi i materialeve;
3. Drejt një shkolle efektive për gjithëpërfshirje;
4. Gjithëpërfshirja përmes nxënies dhe mësimit aktiv për shndërrimin e shkollës speciale në qendër burimore;
5. Gjithëpërfshirja përmes nxënies dhe mësimit aktiv;
6. Udhëheqja e aktiviteteve verore dhe edukimi aktiv për integrim.

Një rol të rëndësishëm në këtë shkollë e ka shërbimi pedagogjik, i cili bën identifikimin e rasteve dhe shërbimit mbështetës të qendrës burimore i ofron informata për nxënësit të cilët kanë nevojë për mbështetje profesionale, organizon takime me prindërit dhe mësimitdhënësit e shkollës.

Përshkrimi i rastit

A.H. ka ndjekur mësimet në qendër burimore deri në klasën e katërt. Me kërkesën e prindërve dhe të mësueses së klasës është vlerësuar nga ekipi vlerësues pedagogjik i qendrës dhe është rekomanduar për përfshirje në shkollë të rregullt, pjesërisht në lëndët e shkathtësive. A.H. kishte vështirësi në socializim dhe komunikim - në të folur. Në këtë aspekt, ajo më mirë mund të arrijë t'i zhvillojë këto shkathtësi në shkollë sesa në qendër burimore.

Mësuesja udhëtuese e qendrës, së bashku me të, ka qëndruar në shkollë për një kohë, derisa ajo është adaptuar. Shkolla, shtëpia dhe qendra burimore ishin afër njëra-tjetrës, kështu që mundësonin bashkëpunim, ishte më lehtë që orari të përshtatej nga të dy shkollat dhe të realizohej lëvizja nga një objekt në tjetrin për një kohë të shkurtër.

Në qendrën burimore A.H. merrte mësim në lëndët: gjuhë shqipe e matematikë, ndërsa lëndët e shkathtësive në shkollën e rregullt.

Pas një viti, sukcesi i nxënësës A.H. ishte i dukshëm dhe ekipi vlerësues pedagogjik i QB bëri rivlerësimin pedagogjik.

Ekipi vlerësues, duke u bazuar në informatat e mësueses së shkollës si dhe në suksesin e arritur nga nxënësja (e cila ishte socializuar me të gjithë nxënësit, merrte pjesë në të gjitha aktivitetet në klasë-shkollë), rekomandoi që nxënësja A.H. të përfshihej me orar të plotë në klasën V (e pestë) me PIA në SHFMU "Musa Hoti" Mitrovicë.



Prindërit e nxënës A.H. si dhe ekipi vlerësues nga qendra burimore rekomanduan që ajo të integrohej në klasën time me orar të plotë, pasi ajo, tashmë një vit, dy herë në javë, ishte e pranishme në mesin tonë në lëndët e shkathtësive.

Pasi e pranova nxënësen A.H. në procesin mësimor, pjesërisht në klasën tonë, paraprkishtë i përgatita nxënësit, duke krijuar një klimë të mirë për mirëseardhjen e nxënës A.H., ngase nxënësit ishin shumë të kuptueshëm dhe e mirëpritën me shumë ngrohtësi e dashuri.

Po ashtu, edhe prindërit e mirëpritën këtë vendim timin, vetëm se ishin kureshtarë të dinin më shumë rreth nxënës në fjalë (pasi që edhe me prindër kemi ndërtuar raporte shumë të mira, i kuptojnë udhëzimet në situata të ndryshme).

Nuk ishte e lehtë, pasi në fillim nxënësja e kishte të vështirë të adaptohej në atë rreth; nuk ndiente siguri, fillonte të qante herë pas here, kërkonte që mësuesja udhëtuese të qëndronte pranë saj. Të gjithë ne ishim të panjohur për të, mësuesja udhëtuese qëndroi një kohë të gjatë me nxënësen A.H., derisa ajo filloi të përshtatej.

Pas disa takimeve që kisha me ekipin vlerësues të QB, me drejtorin, z. Hajdar Shyti, si dhe pas insistimit permanent të prindërve të saj që të përfshihet me orar të plotë, e dija se nuk do ta kem të lehtë, por pikërisht për nxënësen A.H. u përpoqa të bëj gjithçka, sipas mundësive të mia.

Mësimdhënia dhe nxënia janë veprimtari ndërpersonale, në kuadër të së cilës planifikoj dhe organizoj zhvillimin e procesit mësimor. Mirëpo, tani është me i vështirë menaxhimi i orës mësimore, pasi që A.H. ka vështirësi në komunikimin verbal, e kjo ka ndikuar edhe në komunikimin e saj me shkrim. Andaj, duhet të planifikohet dhe të ndahet kohë enkas kushtuar A.H., në bazë të PIA-s.

Kam shumë shembuj, por do të ndalem te kjo përvojë pozitive, duke krahasuar ditët e para të A.H.. Tani shoh fytyrën e saj të buzëqeshur dhe atë shumë të socializuar me shoqet dhe shokët. Nuk veçon kurrë ndonjërin, ngase ajo i adhuron të gjithë dhe është shumë e lumtur, duke më bërë edhe mua të ndihem mirë.

Është mjaft e dhimbshme derisa po e shoh gjendjen aktuale të nxënës A.H. (për vështirësitë verbale). Gjatë orëve mësimore nxënësit arrijnë të flasin, të pyesin, të debatojnë, e, nga ana tjetër, shoh nxënësen që nuk mund të shprehet, ndërsa fytyra e saj shpeshherë ma thotë përgjigjen, ngase unë arrij t'ia lexoj mendjen dhe i them atë çfarë mendoj, e ajo më bën ta kuptoj mënyrën e saj sipas reagimeve

Në klasën time mbretëron një atmosferë e ngrohtë, nxënësit e përkrahin dhe e shoqërojnë gjithnjë, kanë raporte shumë të mira me njëri-tjetrin, shpeshherë atë e ndihmojnë edhe në detyra të ndryshme, ngase qysh në fillim unë i këshillova nxënësit që të kishin respekt ndaj shoqes së tyre të re.

Bashkëpunimi me prindër është në nivel të duhur, kemi raporte të mira, gjithherë më kuptojnë, kur kalojmë nëpër situata të ndryshme dhe të këtitilla, sikur ky rast.

Angazhimi i vazhdueshëm i stafit të QB "Nëna Terezë", më ka nxitur për një punë efektive dhe më të suksesshme në rolin kyç për nxënësen A.H. Si mësimdhënëse e shkollës së rregullt nuk kam pasur përvoja të tilla, por tani u ballafaqova me nxënësen në fjalë. Fillimi ishte i vështirë, si për mua ashtu edhe për nxënësen A.H., por kur ka vullnet dhe dëshirë për një punë të mirëfilltë dhe pragmatike, mendoj se edhe cilësia aty nuk do të mungojë.

Diversiteti i punës sonë është sfidues, por njëherësh na bën më të qëndrueshëm ndaj çdo sfide me të cilën ne ballafaqohemi.

Intervistë e realizuar me mësuesen Rrezearta Kazagiqi në shkollën "Musa Hoti" të Mitrovicës

Për të dokumentuar praktikat pozitive të mësuesës Rrezeartë për nxënësen A.H ne kemi realizuar intervistën si vijon:

Gjatë bisedës-intervistës, mësuesja Rrezearta Kazagiqi tregon se si ka rrjedhur ecuria e procesit gjithëpërfshirës:

Shkolla gjithëpërfshirëse “Bedri Gjina” Mitrovicë


Stafi i shkollës, nxënësit, prindërit dhe anëtarët e komunitetit punojnë së bashku, në mënyrë që të ndihmojnë çdo fëmijë të zhvillohet me tërë potencialin e tij/saj të plotë, në një ambient ku të gjithë ndihen të mirëpritur, të respektuar dhe të vlerësuar dhe ku zhvillojnë kompetenca që kontribuojnë në kohezionin social dhe në zhvillimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse.

Vizioni i shkollës:

“Shkolla të jetë gjithëpërfshirëse, ku nxënësit, prindërit, mësimmshënësist dhe të gjithë të tjerët janë të mirëseardhur, me qëllimin më të mirë për një të ardhme në hap me kohën.”



Fig. 22 - Shkolla e hapur



Përshkrimi i rastit

Nxënësi A.B. ka vijuar procesin mësimor në qendrën burimore deri në klasën IV, më pas është vlerësuar nga ekipi vlerësues pedagogjik i qendrës dhe është dhënë rekomandimi që nxënësi të përfshihet në shkollën më të afërt, në këtë rast në SHFMU "Bedri Gjina". Nxënësi tani vijon mësimin në klasën V, duke u mbështetur vazhdimisht nga shërbimet e qendrës burimore me material didaktik të modifikuar, PIA dhe këshilla të vazhdueshme. Nxënësi ka zhvillim të vonshëm, vështirësi në komunikim, në aspektin social nuk ishte i shoqërueshëm.



Fig. 23 - Aktivitete në grupe



Mësuesja e klasës

Mësuesja Suada Haxhiu është mjaft e përkushtuar në profesionin e saj dhe ka treguar sukses e humanizëm të lartë në këtë aspekt. Përveç nxënësit në fjalë, në klasën e saj ajo ka edhe dy nxënës me vështirësi në mësim. Përmes intervistës së realizuar tregon më hollësisht për punën e saj në klasë me nxënësin A.B.

Që nga fillimi, kur është përfshirë nga qendra burimore në klasën time, nxënësi A.B. ka vijuar me orar të plotë, duke u mbështetur me PIA.

Në fillim puna ime ka qenë mjaft e vështirë, pasi më parë nuk kam pasur rast të punoj me nxënës me nevoja të veçanta. Mirëpo, përkushtimi i prindërve dhe i vetë nxënësit sot me bëjnë të ndihem krenare që A.B. është në klasën time dhe ka arritur të përfshihet në të gjitha aktivitetet e organizuara në klasë - shkollë.

Si mësuese, jam e gatshme që çdoherë të kem nxënës me nevoja të veçanta të përfshirë në klasën time, natyrisht duke pasur parasysh që gjithnjë, kur kemi të bëjmë me nxënës të tillë, të kemi përkrahjen profesionale brenda shkollës, si: një mësuese mbështetëse apo asistente të kualifikuara në këtë drejtim.

Sfidat - Puna ime në procesin mësimor me nxënësin A.B. nuk ka qenë aspak e lehtë.

Vështirësitë kanë qenë të pranishme në çdo aspekt, si: ambientimi i nxënësit në rrethin e ri shoqëror, mbështetja nga nxënësit e tjerë, bashkëpunimi dhe mirëkuptimi i prindërve të tjerë.

Mungesa e trajnimeve dhe e përgatitjes profesionale në këtë aspekt, më vështirësonte qasjen me nxënësin, përshtatjen në mësim, hartimin e PIA-s etj. Po kështu, numri i madh i nxënësve në klasë dhe dy nxënës të tjerë me vështirësi në proces mësimor, paraqitnin vështirësi shtesë.

Ka pasur raste kur nxënësi gjatë tërë ditës nuk ka qenë aspak i përqendruar në mësim, emocionalisht nuk ka qenë mirë (tërë ditën i përlotur), e sidomos pas pushimeve të gjata, në mungesë të shokut të tij, për shkaqe shëndetësore. Edhe për mua ka qenë mjaft i vështirë menaxhimi i këtyre situatave me këtë nxënës dhe në të njëjtën kohë angazhimi me nxënësit e tjerë.

Bashkëpunimi me prindër më ka ndihmuar shumë, edhe pse në fillim ata kanë hezituar për të treguar gjendjen reale, por më pas janë bindur se për të arritur suksese pozitive, ne duhet të punojmë së bashku. Tani ata janë të hapur në kërkesat dhe njoftimet e tyre.

Për të arritur suksese, i vetëm nuk mund të realizosh asgjë, andaj bashkëpunimi që kam me shërbimet mbështetëse të qendrës burimore më ka ndihmuar shumë, nëpërmjet këshillave, hartimit dhe rishikimit të PIA-s dhe mbështetjes me material të modifikuar, që të arrij sukses me nxënësin A.B.



Fig. 24 - Funksionimi i procesit mbështetës

Nxënësi A.B. ka arritur të krijojë shoqëri më të gjithë nxënësit, të cilët e përkrahin dhe e shoqërojnë vazhdimisht, si në proces mësimorë ashtu edhe jashtë tij. A.B. i pëlqen muzika dhe merr pjesë aktive në veprimtari të organizuara në kuadër të shkollës, në programe të ndryshme festive.

Një mesazh për mësimdhënësit e tjerë

Fëmijët janë krijesa të çiltra, jemi ne dhe prindërit që i përgatisim ata për një të ardhme të ndritshme. Mos hezitoni të jeni edhe ju pjesë e kësaj pune. Edhe pse dikur kam menduar se ata fëmijë (me nevoja të veçanta) duhet të jenë të ndarë, sot me kuptimin e plotë të fjalës them që duhet të inkuadrohen dhe të jenë pjesë e shoqërisë në çdo sferë. Mos i refuzoni, por jepni çdo gjë nga vetja, sepse në të ardhmen arritjet e tyre do të jenë fryt i punës sonë. Nuk është e lehtë, por është kënaqësi kur sheh arritjet e këtyre nxënësve.



Fig. 25 - Aktivitete jashtëmësimore



Praktika pozitive në arsimin gjithëpërfshirës



3.4. Qendra burimore për mësim dhe këshillim "Nëna Terezë" në Prizren

Qendra burimore për mësim dhe këshillim “Nëna Terezë” në Prizren ka një histori të gjatë në fushën e rehabilitimit, edukimit dhe arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe në të folur.

Gjatë punës në qendër dhe jashtë saj, mësuesit dhe ekipet profesionale janë ballafaquar me nxënës me specifika të ndryshme në mësim.

Aktivitetet e ekipit të mbështetjes dhe mësuesit udhëtues janë sasiore dhe cilësore në punë.

Në grafik janë paraqitur vizitat e realizuara për dhënien e shërbimeve profesionale në shkolla të rregullta në Kosovë.




Fig. 26 - Raporti i vizitave të mësuesit udhëtues institucioneve arsimore të Kosovës gjatë vitit shkollor mësimor 2014/2015




Fig 27 - Numri i nxënësve të identifikuar, të përkrahur e të mbështetur nga mësuesi udhëtues gjatë vitit shkollor mësimor 2014/2015



Përshkrimi i rastit

Pas identifikimit të nxënësit, kemi filluar vizitat sistematike edhe në shkollë për të përkrahur shkollën, mësuesit dhe nxënësin.

Për të marrë informata më të plota, kemi bashkëbiseduar me familjen/kujdestaren e fëmijës.

Nxënësi i vijon mësimet në një shkollë të rregullt, është në klasën e gjashtë (VI) dhe përbrenda sistemit të rregullt ka qenë jo i përfshirë në aktivitete mësimore dhe jashtëmësimore.

Shkolla nuk posedonte dokumentacion të kompletuar mbi vlerësimin e përgjithshëm.

Pas bashkëpunimit me mësime nxënësit, është hartuar Plani Individual i Arsimit dhe mësime nxënësit kanë marrë informata lidhur me zbatimin e tij.

Pas përfshirjes në proces dhe në aktivitete, nxënësi është më i lumtur, vjen çdo ditë në shkollë. Familja gjithashtu shpreh mirënjohje për gjendjen e tanishme të fëmijës.

Trajtimi dhe qasja

Niveli i zhvillimit arsimor-edukativ i N.N., sipas vlerësimit profesional, ishte mesatar. Kemi filluar me zhvillimin e shkathtësive të jetës së përditshme, si: veshmbathja, ushqimi, pastrimi i duarve, i fytyrës dhe mirëmbajtja e higjienës personale.

- Aktivitete fizike-zhvillimi i shkathtësive fizike (motorika e vogël dhe e madhe);
- Aktivitete në zhvillimin e komunikimit, oral-verbal, si dhe me gjuhën e shenjave;
- Aktivitete në fushën socio-emocionale, interaksion social (qëndrimi me shokë dhe loja më shokë);
- Aktivitete të ndryshme më argjilë-plastelinë, vizatime, mbajtja e lapsit, përdorimi i lapsit dhe ngjyrave;
- Shkrimi i shkronjave dhe numrave, vizatim;
- Komunikim - konvergencë e fjalëve dhe tingujve.

Metodat që janë aplikuar gjatë punës më nxënësin: sqaruese, shtjelluese, demonstruese, imituese, ilustruese, konkretizuese. Metoda e komunikimit më nxënësin: të folurit, gjuha e shenjave (shenja - sugjerime), metoda e komunikimit total etj.

Materialet mësimore janë përgatitur në mënyrë të kujdeshme, duke aplikuar ilustrime, vizatime, skicime të ndryshme, dhe u janë përshtatur aftësive e mundësive pranuese të nxënësit.

Mjetet mësimore specifike të aplikuara gjatë punës më këtë rast janë:

- Hartat e koncepteve, - Kafshët, - Gjësendet, - Mjetet e transportit, - Ngjyrat, -Format e ndryshme, - Stinët e vitit, - Veshjet, - Mjetet muzikore, - Pajisjet për ushqim;
- Kartelat për çiftëzim - e gjatë - e shkurtër, - e madhe - e vogël,- e trashë - e hollë, - mbi - nën,- brenda - jashtë, - para - mbrapa,- afër - larg;
- Puzzle të letrës dhe të drurit, - Pemët, - Perimet, - Mjetet e komunikacionit, - Trupi i njeriut, - Gjësendet e ndryshme.

Përkrahja për nxënësin me aftësi të kufizuara nga bashkëmoshatarët

Për mësuesin në klasë të rregullt kemi siguruar materiale të përshtatshme mësimore specifike, gjithashtu kemi instaluar një bashkëpunim të përafërt, kemi ofruar sugjerime dhe këshillime profesionale. Aktualisht nxënësi ka arritur që të ketë performancë më pozitive se në të kaluarën, ka përmirësim në aspektin e ndërveprimit social, me një fjalë është në gjendje më të mirë sesa ka qenë më parë, përparimi është evident, arritjet janë graduale.



Fig. 28 - Vizatim i nxënësit



Praktika pozitive në arsimin gjithëpërfshirës

Qendra burimore për mësim dhe këshillim "Nëna Terezë" në Prizren gjatë dy vjetëve të fundit, pos të tjerash, ka ofruar një numër të trajnimeve për mësuesit e shkollave të rregullta të komunës së Prizrenit dhe regjionit në ngritjen e kapaciteteve të shkollave të rregullta për të implementuar politikat inkluzive në arsim, për të zhvilluar njohuritë bashkëkohore mbi qasjen metodike, aplikimin e metodave bashkëkohore, strategjive dhe teknikave për një punë produktive me nxënësit me aftësi të kufizuar dëgjimi. Në trajnime kanë marrë pjesë: mësues edukatorë dhe udhëheqës të institucioneve arsimore.

Temat e trajnimit	Numri i të trajnuarve –I- Dyditor	Numri i të trajnuarve –II- Katërditor
1. Strategjitë e mësimdhënies për nxënësit me paaftësi dëgjimi	22	28
2. Qasja arsimore fëmijëve me aftësi të kufizuar dëgjimi	22	28
3. Strategjitë lehtësuese të qasjes nxënësve me aftësi të kufizuar dëgjimi	22	28
4. Zhvillimi i fjalorit të nxënësve me aftësi të kufizuar dëgjimi	22	28
5. Gjuha e shenjave	22	28
6. Zhvillimi i aftësive gjuhësore të nxënësve me aftësi të kufizuar dëgjimi	22	28



Praktika pozitive në arsimin gjithëpërfshirës



3.5. Qendra burimore për mësim dhe këshillim “Xheladin Deda” në Pejë

Qendra burimore “Xheladin Deda” në Pejë është e para shkollë, që në vitin 2005 është shndërruar në qendër për të dhënë shërbime për fëmijët e verbër në Kosovë. Dhe nga atëherë kjo qendër ka dhënë shërbime dhe mbështetje profesionale.

Në punën e përditshme ka shumë sfida, por edhe praktika të mira, që janë motiv për punë.

Procesi i gjithëpërfshirjes së nxënësve të verbër në shkollat e rregullta është rrugë që duhet ndërtuar me mësimdhënës të trajnuar, me kuadër profesional, në mënyrë që barrierat të kapërcehen.

Qendra burimore, përveç ekspertizës, në shkolla të rregullta ka sjellë mësuesit udhëtues dhe staf tjetër të shkollës, që përgatisin materiale të ndryshme në Braill, për të ndihmuar nxënësit e përfshirë në sistem të rregullt arsimor. Ajo sjell edhe pajisje të ndryshme për të lehtësuar procesin e të nxënësve; material didaktik, i prodhuar në shkronja të zmadhuara, letër Braill, makina për shkrim Braill, tabela lëvizëse dhe të tjera materiale, sipas nevojave individuale të nxënësve.



Fig. 29 - Leximi në Brai

M.H. ka filluar shkollën në qendrën burimore "Xheladin Deda" në Pejë në klasën I tek mësuesja Zoje Nikqi.

Pasi u konstatua se nxënësja kishte inteligjencë të lartë dhe mund të integrohej në shkollë të rregullt, qendra burimore, përmes mësuesve udhëtues, filloi përgatitjet.

U identifikua shkolla më e afërt, filloi bashkëpunimi me prindërit.

Mësuesit udhëtues vizituan shkollën "Ismail Qemali" në Prishtinë dhe, në takim me drejtorinë e shkollës, u paraqit kërkesa për fillimin e integritit.

Duhej të gjendej klasa me jo më shumë se 25 nxënës, mësuesja e trajnuar për arsim gjithëpërfshirës.

Ishte sfidë për familjen, mësuesit dhe për vetë qendrën burimore, por ato filluan të kapërcehen me vullnetin për të arritur sukses në përfshirjen në klasë, aty ku M.H. i garantohej shkollimi me ligjet dhe aktet nënligjore.

Punë e mirë ishte vetëdijesimi i nxënësve të rregullt që në mesin e tyre do të jetë një nxënës që mësimin do ta marrë me shkrimin e Braillit. M.H. do të ndihmohet nga mësuesit udhëtues. Do të përgatiten materiale mësimore në Brail, sipas kurrikulës së rregullt.

Është punuar që nëna e Marigonës ta mësojë shkrimin në Brail, për ta ndihmuar vajzën në detyra dhe obligime të tjera.

Tani M.H. ndjek mësimet në klasën VI me sukses të shkëlqyeshëm. Jeton në lagjen e saj me bashkëmoshatarët dhe pranë familjes.

Mësuesit udhëtues në qendrën burimore "Xheladin Deda" në Pejë



Praktika pozitive në arsimin gjithëpërfshirës



4. Përfundim



Hulumtimi në veprim, i realizuar nga mësuesit udhëtues, u ka dhënë përgjigje pyetjeve të ngritura lidhur me gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në klasa të rregullta.

Në bazë të kësaj, mund të përfundojmë se:

- o Ekziston bazë ligjore për përfshirjen e fëmijë me nevoja të veçanta në arsim;
- o Mësimdhënësit kanë ndjekur trajnime në fushën e arsimit gjithëpërfshirës;
- o Përvojat e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta, janë kryesisht pozitive;
- o Mësimdhënësit arsimit gjithëpërfshirës fillimisht i qasen nga aspekti human dhe pastaj vazhdojnë me ngritjen e njohurive dhe kompetencave për punë;
- o Praktikrat pozitive mund të ndikojnë që arsimit gjithëpërfshirës të jetë prioritet i shkollave.

Kur është fjala për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta, është me rëndësi të kemi mësues të trajnuar, prindër të vetëdijesuar dhe mbështetje profesionale, të cilat t'i plotësojnë nevojat për zhvillim të çdo fëmije me potencialin e mundshëm për zhvillim.

Mësuesit që punojnë me nxënës në këto klasa kanë nevojë për mbështetje profesionale lidhur me:

- o identifikimin e nevojave adekuate të fëmijëve lidhur me procesin e mësimin,
- o hartimin e planit individual të arsimit,
- o metodat dhe teknikat mësimore,
- o hartimin e materialeve mësimore specifike,
- o njohjen me praktika pozitive.

Në bashkëpunim të ngushtë me mësuesit udhëtues, ata kanë filluar të kapërcejnë sfidat e përditshme në punë me fëmijë dhe kompetenca profesionale është në rritje për ballafaqim me vështirësitë eventuale.

Me modelet gjithëpërfshirëse, mësuesit mund të përparojnë kompetencat e tyre profesionale, me idenë e njohjes më të mirë të nevojave specifike të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në zhvillimin e përgjithshëm.

Mësuesit e kanë mundësinë që, me gjithë vështirësitë në punë, të mësojnë strategji mësimore dhe teknika të ndryshme, të cilat do të ndikojnë në ngritjen e kualitetit të mësimdhënies.

Dobitë nga arsimit gjithëpërfshirës janë në të gjitha nivelet, duke filluar nga fëmijët, familja, shkolla, sistemi i arsimit deri te bashkësia lokale. Fëmijët kanë më shumë gjasa të zotërojnë shkathtësi të caktuara dhe të arrijnë njohuri që do t'u mundësojnë më lehtë të përfshihen në shoqëri dhe të kenë jetë më kualitative.

Shkollat, me pranimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, do ta rrisin numrin e nxënësve, do ta ngrenë kualitetin e arsimit, do të bëhen më humane dhe më të hapura për të gjithë.

Dhe krejt kjo shpie në një shoqëri më tolerante në dallime.



Praktika pozitive në arsimin gjithëpërfshirës

Me arsim gjithëpërfshirës shteti dhe shoqëria arrijnë të plotësojnë qëllimet strategjike për arsim më cilësor dhe për të gjithë.

Linku:

(SOT - Qendra burimore "Nëna Terezë" në Mitrovicë, 26 01 2016) e realizuar nga televizioni Kohavision - KTV



SHTOJÇË

Qendra burimore "Nëna Terezë" Prizren

Pyetësor për nxënës

Ky pyetësor është pjesë e një studimi shkencor, i ndërmarrë me qëllim vlerësimi të rezultateve të përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në QB si dhe intencë që fëmijët të integrohen në sistemin e arsimit gjithëpërfshirës. Të dhënat e studimit do të jepen të përmbledhura, pa i përmendur emrin personit që ka plotësuar pyetësorin. I gjithë informacioni që do të merret nga ky studim do të trajtohet si informacion konfidencial dhe do të jetë në dispozicion vetëm të studiuesit që do t'i përpunojë të dhënat e këtij studimi. Ju lutem, përgjigjuni me vërtetësi çdo pyetjeje, në mënyrë që të dhënat që do të grumbullojmë të paraqesin gjendjen reale, me të gjitha arritjet dhe vështirësitë. Paraprakisht ju falënderojmë për kontributin në këtë studim.

Emri i shkollës _____ Vendndodhja _____

1.) Në cilën klasë i vijoni mësimet? _____

2.) A jeni të kënaqur me shërbimet që ju ofrohen në shkollë?

- a.) Shumë
- b.) Pak
- c.) Aspak

3.) A jeni të kënaqur me sjelljen e stafit arsimor të shkollës?

- a.) Shumë
- b.) Pak
- c.) Aspak

4.) A do të dëshironit që vitet e mbetura shkollore t'i vazhdonit në QB?

- a.) Po
- b.) Jo
- c.) Nuk e di

5.) A do të dëshironit që mësimet t'i vijonit me bashkëmoshatarët tuaj në?

- a.) Shkollë të rregullt
- b.) Klasë burimore
- c.) Klasë gjithëpërfshirëse
- ç.) QB



- 6.) A do të pranoni rekomandimin e komisioni për vlerësim që ju mësimet t'i vijoni në shkollë të rregullt?
- a.) Po
 - b.) Jo
- 7.) Ku do të dëshironit t'i vijoni ju mësimet?
- a.) Shkollë të rregullt-gjithëpërfshirëse
 - b.) QB
- 8.) A mendoni se vlerësimi i komisionit vlerësues ka qenë korrekt?
- a.) Po
 - b.) Jo
- 9.) Si sillen familjarët me ju?
- a.) Shumë mirë
 - b.) Mirë
 - c.) Jo mirë
- 10.) Si sillen bashkëmoshatarët tuaj në lagje, rrugë, lojë, qytet me ju?
- a.) Shumë mirë
 - b.) Mirë
 - c.) Jo mire

Pyetësor për mësimdhënës

Emri i shkollës _____ Vendndodhja _____

1. A ndiheni kompetent nëse në klasën inkluzive keni një nxënës **më aftësi të kufizuara**?
- a.) Po
 - b.) Jo
- 2.) A jeni të kënaqur me shërbimet që shkolla ofron për punë me nxënësit me aftësi të kufizuara dëgjimi?
- a.) Shumë
 - b.) Pak
 - c.) Aspak
3. Si e vlerësoni idenë e inkluzionit?
- a.) Shumë të mirë
 - b.) Pak
 - c.) Aspak



- 4.) A keni në klasën tuaj nxënës me aftësi të kufizuara?
 - a.) Po
 - b.) Jo
5. A mendoni se jeni të përgatitur për realizimin e idesë së inkluzionit?
 - a.) Po
 - b.) Jo
6. A do të pranoni që në klasën tuaj të keni një fëmijë me aftësi të kufizuara?
 - a.) Po
 - b.) Jo
7. A keni njohuri mbi përpilimin e PIA-s?
 - a.) Po
 - b.) Jo
- 7.) A mendoni se edhe nxënësit me aftësi të kufizuara duhet t'i vijojnë mësimet në të njëjtën shkollë?
 - a.) Po
 - b.) Jo



Pyetësor për drejtor

- Misioni i shkollës:

- Vizioni i shkollës:

1. Shkruani numrin e nxënësve me nevoja të veçanta për secilën klasë?

I _____	IV _____	VII _____
II _____	V _____	VIII _____
III _____	VI _____	IX _____

2. Cekni më poshtë nevojat – vështirësitë e nxënësve?

Vështirësi në të parë

Vështirësi në të dëgjuar

Vështirësi në folur



3. Si keni bërë identifikimin e nxënësve me nevoja te veçanta dhe kush e ka bërë këtë?

4. Çfarë keni bërë për përfshirjen e drejtë të fëmijëve me nevoja të veçanta?

- Identifikim e fëmijëve me nevoja të veçanta
- Njohja me prindërit dhe marrja e informative për fëmijë me nevoja të veçanta
- Njoftimi i prindërve të tjerë për përfshirjen e fëmijëve me nevoja te veçanta
- Të tjera _____

5. Shkolla juaj nuk ka ashensor dhe mundësi për të kaluar nxënësit me karrocë në katin e dytë, si gjinden këta nxënës.

Në cilat trajnime keni nevojë për ti ndjekur?

1.

Nëse jo nga kush jeni keni marrë trajnime për nxënës me nevoja te veçanta

Nga MASHT, DKA, QB, etj.

A keni mbështetje për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta

Po

Jo

Nëse po nga kush dhe çfarë shërbimesh merreni

- QB _____
- MU _____
- DKA _____
- MASHT _____
- OJQ _____

Çfarë shërbimesh ofron psikologjia e shkollës për fëmijë me nevoja te veçanta?

Si siguron materialet mësimore për fëmijë me nevoja të veçanta?

- Përgatit mësuesja
- Sigurohen nga shkolla



Praktika pozitive në arsimin gjithëpërfshirës

- Përgatiten nga psikologja
- Ofrohen nga mësuesit udhëtues
- Të tjera _____

Cilat janë format e bashkëpunimit me prindër?

A janë të angazhuar edhe mësuesit që nuk kanë në klasë të tyre FNV dhe në çka janë të angazhuar?

Si është qasja e nxënësve të tjerë në raport me fëmijë me nevoja të veçanta?

A është bërë ndarja e nxënësve me nevoja te veçanta sipas udhëzimit administrativ ?

Po jo

Nëse jo si e keni bërë ndarjen?

A ka me shumë se dy nxënës me nevoja te veçanta në klasë ?



Pyetësor për mësime dhënë

Qëllimi i këti pyetësori është mbledhja e të dhënave në dokumentim të formave dhe mënyrën e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor. Pyetësori do të jetë konfidencial andaj ju lutem të jeni sa më të saktë në përgjigjet tuaja!!!

Gjinia	F	M		
Mosha	20-30	30-40	40-50	50-60

Kualifikimi _____

Klasa _____

Numri i nxënësve në klasë _____

Numri i nxënësve me nevoja të veçanta dhe lloji i vështirësive të tyre _____



1. Përgatitja juaj për edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, lloji i trajnimeve dhe nga kush keni marrë trajnimet? (shkruaj)

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

2. Parapërgatitjet e juaj për vitin shkollorë në lidhje me përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta?(shkruaj)

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

3. Si i keni identifikuar nxënësin me nevoja të veçanta dhe kur e keni bërë këtë?



4. Si keni njoftuar prindërit për rastin dhe si e kanë pritur ata?

5. Si i keni njoftuar prindërit e tjerë për fëmijën me nevoja të veçanta dhe si e kanë pritur atë?

6. Si e presin nxënësit tjerënxënësin me nevoja të veçanta?

7. Si i keni përgatitur nxënësit tjerë për përfshirjen e nxënësit me nevoja te veçanta në klasë?

8. A kanë nxënësit tuaj planin individual te arsimit dhe kush ju ka ndihmuar ne hartim ti tij?

9. A janë të përfshire prindërit në hartim të PIA-s?

PO JO

10. Çfarë mbështetje merrni nga psikologu i shkollës?

- _____
- _____
- _____

11. Çfarë mbështetje merrni nga Qendra Burimore?



- Hartimi i PIA-s
- Rishikimi i PIA-s
- Trajnime
- Materiale didaktike
- Këshillime
- Mësim plotësues
- Të tjera _____

12. A merrni mbështetje tjetër dhe nga kush keni këtë mbështetje?

13. Si qëndron bashkëpunimi me mësimdhënësit tjerë brenda shkollës?

14. Sa keni mbështetje nga stafi menaxhues i shkollës dhe në çka merreni mbështetje?

15. Cilat janë metodat e punës që përdoreni me nxënës me nevoja të veçanta?

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

16. Ku është i ulur nxënësi nëklase?

(Rrumbullakos një rën nga zgjedhjet dhe arsyeto pse)

- Nëqifte me nxënësin që ai ka zgjedhur
- Në grup me nxënësit tjerë
- Vendi nxënësit ndërrohet varësisht si ndërrohet edhe vendet e nxënësve të tjerë
- Nxënësi është i ulur vetëm
- Të tjera _____



Arsyeje

17. Cilat janë sfidat e punës suaj në raport me fëmijë me nevoja të veçanta?

18. Si keni kaluar këto sfida të punës?

19. Çfarë mendoni të bëni më shumë në përmirësim të përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në klasën tuaj?

Ju faleminderit !!!!




Pyetësor për psikolog

Qëllimi i këtij pyetësori është mbledhja e të dhënave në dokumentim të formave dhe mënyrën e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor. Pyetësori do të jete konfidencial andaj ju lutem të jeni sa më të saktë në përgjigjet tuaja!!!

Gjinia F
Moshë 20-30 30-40 40-50 50-60
Kualifikimi : Mr. i psikologjise shkollore

- 1. Si i identifikoni nxënësit me nevoja të vecanta?**
- 2. Sa nxënës janë duke e ndjekur mësimin në këtë shkollë?**
- 3. Si i sistemoni nxënësit në klasën e parë(nëse keni njohuri për nxënësin paraprakisht ose raport)**
- 4. Cila procedurë ndiqet pas identifikimi të nxënësve me N.V**
- 5. Cilat janë procedurat e mëtutjeshme pas hartimit të planit individual të arsimit?**



MITROVICË

Intervista e realizuar me mësimdhënësen në Shfmu. "Musa Hoti" dhe "Bedri Gjina" Mitrovicë

PYETJET

1. Iniciativa për përfshirjen e nxënësve/it me orar te plotë?
2. Reagimi juaj si mësimdhënëse?
3. Reagimi i nxënësve tjerë se si e kanë mirëpritur?
4. Reagimi i prindërve?
5. Cilat kanë qenë sfidat gjatë mësimdhënies në fillim?
6. Gadishmeria juaj për gjithpërfshirjen e nxënësve?
7. Vështirësit që ballafaqoheni gjatë mësimdhënies?
8. Përshkruani një shembull pozitiv në klasën tuaj?
9. Një shembull që ju ka bërë të ndiheni keq gjatë përvojës tuaj?
10. Si është gjendja momentale në klasën tuaj dhe se sa e përkrahin nxënësve tjerë ..?
11. Cili është niveli i bashkëpunimit me prindërit?
12. A ju ka mjaftuar përkrahja nga shërbimet mbështetëse të Qendres Burimore?
13. Një mesazh për mësimdhënësit tjerë që kanë nxënës me nevojë të veçanta në klasë ?



Qendra burimore "Lef Nosi" Prizren

PYETËSOR PËR PRINDËR

1. Si e priti kërkesën shkolla për regjistrimin e fëmijës suaj?
2. Si e pritën nxënësit e tjerë fëmijën tuaj në klasë?
3. A bashkëpunoni me mësuesin?
4. Sa jeni të kënaqur me rezultatet e arritura?
5. A jeni të kënaqur me punën e mësuesit?

PYETËSOR PËR DREJTORIN

1. A ka infrastrukturë të mirë (të duhur) shkolla juaj për përshtatjen e nxënësve me nevoja të veçanta?
2. Në çfarë niveli është bashkëpunimi i shkollës suaj me prindërit, institucionet e tjera dhe organizatat që merren me fëmijë me nevoja të veçanta?
3. Si bëhet pranimi i nxënësve me nevoja të veçanta dhe a pranojnë mësuesit me kënaqësi të punojnë me këta nxënës?
4. A ka trajnime të mjaftueshme stafi juaj për punën mësimore me nxënës me nevoja të veçanta?

PYETËSOR PËR MËSUES

1. Në fillim, a e keni pasur të vështirë pranimin e nxënësit me nevoja të veçanta në klasën tuaj?
2. Si është pranuar nxënësi me nevoja të veçanta nga nxënësit e tjerë dhe sa bashkëpunojnë ata me nxënësin me nevoja të veçanta?
3. Cilët kanë qenë hapat që ju keni ndërmarrë në fillim për përshtatjen e nxënësit me n.v. në klasën tuaj?
4. Cilat janë këshillat që jepni për nxënësit e tjerë për pranim dhe ndihmë nxënësit me nevoja të veçanta?
5. Çfarë metoda dhe strategji të mësimdhënies keni përdorur gjatë punës suaj me nxënësin me nevoja të veçanta?
6. A punoni me PIA dhe sa zbatohet ai?
7. Cili është sukcesi i arritur i nxënësit, nga fillimi i mësimin deri më tani?
8. Cilat janë pengesat që janë paraqitur dhe si i menaxhoni?
9. A keni mbështetje të duhur nga mësuesi udhëtues dhe cilat janë format e mbështetjes?
10. Sa është i pavarur nxënësi me nevoja të veçanta gjatë qëndrimit në shkollë, në klasë?



11. Në çfarë niveli bashkëpunoni me prindërit e nxënësit me nevoja të veçanta?
12. Çfarë mjete dhe materiale mësimore përdorni gjatë punës suaj?

PYETËSOR PËR NXËNËSIT

1. A e konsideroni nxënësin me n.v. si shokët e tjerë në klasë?
2. A e ndihmoni shoqen tuaj dhe si?
3. Sa bashkëpunoni me nxënësin me nevoja të veçanta?
4. A e përqesh dhe a e ngacmon dikush atë?
5. Tregoni një ngjarje të shkurtër kur shoqja juaj me n.v. ka pasur nevojë për ju?



Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministri of Education, Science and Technology